

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Profilin Mësimor**

**SHFRYTËZIM PYJESH**

**Niveli III**

**(2 vjeçar)**

**(Në drejtimin mësimor PYJE)**

**Kodi: S2-III-18**

Miratoi:

**MINISTRI**

**Tiranë, 2018**

## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III, të drejtimit mësimor “Pyje”.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III.

**III. Plani mësimor për profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III, të drejtimit “Pyje”.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III, të drejtimit “Pyje”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shfrytëzimin e pyjeve”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profili “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Shfrytëzim pyjesh” niveli III, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Pyje”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MASR përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shfrytëzim pyjesh, niveli III, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse në fushën e shfrytëzimit pyjor.
- Të masë me instrumenta matës gjeodezije dhe të hartojë projekte të ndryshme në veprat hidroteknike dhe ato të rrugëve pyjore .
- Të kuboje grumbullin pyjor dhe atë të drurit në këmbë
- Të ndërtojë prita, murembajtës në përrenj .
- Të kryejë inventarizimin e pyjeve në sipërfaqet pyjore.
- Të përcaktojë asortimentet dhe të ndajë drurët në kategori diamettrash sipas kushteve të standartit shtetëror,
- Të pastrojë parcelat që janë shfrytëzuar dhe të bëjë vlerësimin e tyre .
- Të ruajë dhe të ekonomizojë materialin drusor duke ngritur sheshet e depozitimit dhe duke përdorur metodat e ruajtjes së materialit drusor .
- Të përdorë transportin e brendshëm me traktorë me zinxhirë.
- Të ndërtojë rrugët pyjore ku duhet të kalojë traktori.
- Të piketojë dhe të montojë teleferike të thjeshtë me një ose 2 litare për transportimin e druve të zjarrit dhe degëve të vozave .
- Të transportojë materialin me teleferik (zbritësa të thjeshtë)
- Të prodhojë lëndën e sharruar në pyll me gatër dhe sharrë shirit të lëvizshëm .
- Të vejë në punë vegla dhe makineritë për prodhimin e lëndës së sharruar.
- Të prodhojë rrëshirën si prodhim të dytë të pyllit nga pyjet e pishës së zezë.
- Të ndërtojë kaminin dhe të prodhojë qymyrin e drurit.
- Të ndërtojë drena dhe gabiona të thjeshtë dhe të kryjë punime në kullota pyjore.
- Të piketojë dhe të sistemojë rrugë pyjore .
- Të bëjë punime përgatitore (si piketime, gërmime, mirëmbajtje të rrugëve të brendshme dhe të jashme të parcelave)

- Të trajtojë pyllin për qëllime të posaçme si parqe etj.
- Të inventarizojë dhe të vjelë gjahun në pyll.
- Të kryejë punime me makina të automatizuara të shfrytëzimit të pyjeve.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III, e pajis nxënësin me Certifikatën e teknikut të shfrytëzimit të pyjeve. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit të punësohet në drejtoritë e shërbimit pyjor, pranë komunave dhe bashkive por edhe të vetpunësohet duke hapur biznesin e tij në prodhimet e dyta pyjore, qymyrimin e drurit, prodhimin e rrëshirës, esencave, prodhimin e lëndës së sharruar etj., por edhe në mbrojtjen e mjedistit pyjor. Pas një përvoje pune e trajnimeve të vazhdueshme, ai mund të krijojë një sipërmarrje të vetën duke punësuar edhe individë të tjerë në veprimtaritë e shfrytëzimit të pyjeve.

Me përfundimin e suksesshëm të këtij niveli, nxënësi fiton njëkohësisht edhe Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare si dhe të arsimit pas të mesmes.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III (2018-19).

Plani mësimor për drejtimin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III (2018-19)				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimorë	Orët javorë/vjetorë	
			Klasa 12	Klasa 13
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)</b>	<b>10/11</b> (360/ 396)	<b>14/16</b> (448/ 512)
1		Gjuhë shqipe (dhe Letërsi)	1	2
2		Letërsi	1	-
3		Gjuhë e huaj	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(2)
5		Histori	1	-
6		Gjeografi	1	2
7		Matematikë	2	2
8		Biologji	-	1
9		Teknologji informimi e komunikimi	1	1
10		Histori arti	-	2
11		Edukim fizik, sporte, shëndet	1	-
12		Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji)	-	2
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale (Gjithsej)</b>	<b>9</b> <b>(324)</b>	<b>10</b> <b>(320)</b>
1	L-17-197-11	Bazat e sipërmarrjes	2	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	-	1

3	L-03-229-11	Topogjeodezi	1	-
4	L-25-230-11	Silvikulturë	2	-
5	L-25-279-12	Mbarështrim pyjor	2	
6	L-25-280-12	Teknologjia e shfrytëzimit pyjor	2	2
7	L-25-281-12	Infrastruktura e shfrytëzimit pyjor	-	2
8	L-25-282-12	Pyllëzime artificiale	-	1
9	L-25-236-11	Ligjshmëri pyjore	-	1
10	L-25-234-11	Mbrojtje natyre dhe planifikim teritori	-	1
<b>C.</b>		<b>Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)</b>	<b>9 (324)</b>	<b>6 (192)</b>
1	M-25-646-11	Punime me instrumenta matës gjeodezie	36	-
2	M-25-647-11	Kubimi i grumbullit pyjor dhe drurit në këmbë	36	-
3	M-25-832-12	Punime në veprat hidroteknike pyjore	36	-
4	M-25-833-12	Proçeset e prodhimit në shfrytëzimin pyjor.	72	
5	M-25-834-12	Transporti i brendshëm pyjor	36	-
6	M-25-835-12	Prodhimi i lëndës së sharruar në pyll	36	
7	M-25-661-11	Nxjerrja dhe përpunimi i rrëshirës.	36	
8	M-25-660-11	Shërbime dhe punime në kullota	36	
9	M-25-836-12	Llogaritjet ekonomike në shfrytëzim pyjor	-	33
10	M-25-837-12	Ruajtja dhe ekonomizimi i materialit drusor.	-	48
11	M-25-838-12	Punime përgatitore në rrugë pyjore	-	48
12	M-25-839-12	Prodhimi i qymyrit të drurit	-	33
13	M-25-654-11	Punimet në inventarizimin e pyjeve - 2	-	30
<b>D</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)</b>	<b>2 (72)</b>	<b>-</b>
1	M-25-659-11	Trajtimi i pyllit për qëllime të posaçme	36	-
2	M-25-840-12	Shfrytëzimi i pyjeve me makina të automatizuara	36	-
3	M-25-658-11	Inventarizimi dhe vjelja e gjahut	36	-
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31 (1080/1116)</b>	<b>30/32 (960/1024)</b>

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë

e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Shfrytëzim pyjesh”.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar, sipas Udhëzimeve të MASR dhe MFE.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Shfrytëzim pyjesh”, niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e teknikut të shfrytëzimit të pyjeve, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasave 12-të dhe 13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.



## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-11). Kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 - 68 orë

#### • Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes” në kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/sherbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër \*P\*-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

#### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 72 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
<b>Tema 2</b>	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
<b>Tema 3</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
<b>Tema 4</b>	Organizimi i punës në biznes	9 orë
<b>Tema 5</b>	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
<b>Tema 6</b>	Institucionet financiare	7 orë
<b>Tema 7</b>	Njohuri për Marketingun	5 orë
<b>Tema 8</b>	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
<b>Tema 9</b>	Legjislacioni i punës	7 orë
<b>Tema 10</b>	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
<b>Tema 11</b>	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë
<b>Tema 12</b>	<i>Detyrë praktike</i> për llogaritjet ekonomike në veprimtarinë profesionale	4 orë

#### • Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit
- Të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin i saj në tregun e biznesit.
- Të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit në menaxhimin e biznesit
- Të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në

kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.

- Të dallojnë tiparet dhe aftësitë menaxheriale që lidhen me punën e suksesshme sipërmarrëse.
- Të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit).
- Të menaxhojnë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës
- Të dallojnë konceptet, sistemet, dhe mjetet e nevojshme për të sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznesin.
- Të shpjegojnë nevojën e vlerësimit të tregut dhe dobinë e marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij.
- Të shpjegojnë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- Të hartojnë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës.
- Të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit dhe analizën e burimeve të financimit.
- Të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.
- Të dallojnë kuadrin ligjor dhe detyrimet përkatëse si pjesë aktive e vendimarrjes në një biznes.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Sipërmarrja dhe menaxhimi	4 orë
<b>Tema 2</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	5 orë
<b>Tema 3</b>	Aftësitë menaxheriale	8 orë
<b>Tema 4</b>	Funksionet dhe teknikat e menaxhimit	5 orë
<b>Tema 5</b>	Menaxhimi i burimeve njerëzore	7 orë
<b>Tema 6</b>	Menaxhimi i informacionit	6 orë
<b>Tema 7</b>	Menaxhimi marketing	5 orë
<b>Tema 8</b>	Menaxhimi financiar	9 orë
<b>Tema 9</b>	Zhvillimi i një plani biznesi	7 orë
<b>Tema 10</b>	Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit	7 orë
<b>Tema 11</b>	Kuadri ligjor dhe taksat	5 orë

**2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 34 orë**

• **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në

- lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
<b>Tema 2</b>	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
<b>Tema 3</b>	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
<b>Tema 4</b>	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
<b>Tema 5</b>	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
<b>Tema 6</b>	Monitorimi i burimeve mjedisore	4 orë
<b>Tema 7</b>	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
<b>Tema 8</b>	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
<b>Tema 9</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
<b>Tema 10</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

**3. Lënda “Topogjeodezi” (L-03-229-11), kl. 12 – 36 orë**

• **Synimet e lëndës “Topogjeodezi”, kl 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Topogjeodezi”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë formën e tokës, përmasat e saj .
- Të listojnë shëmbuj të kuotave dhe tregojë rolin e tyre.
- Të përcaktojnë madhësitë kryesore që përdoren në punime topografike.
- Të sqarojnë elementet e hartës topografike .
- Të përcaktojnë largësitë në terren mes pikave që jepen në hartë.
- Të përcaktojnë kuotat e pikave që jepen .
- Të masin kënde horizontale dhe vertikale gjatë punimeve të ndryshme.
- Të masin me metër shirit.
- Të masin sipërfaqe të parcelave me metodën grafike.
- Të llogarisin kordinatat në një poligon.
- Të përdorin instrumentat e nivelimit .
- Të përcaktojnë me instrumenta disnivelelin mes dy pikave në terren.
- Të hartojnë planimetrinë kadastrale në shërbim të ekonomisë pyjore

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Topogjeodezi”, kl.12 - 36 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme mbi topogjeodezinë	3 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri mbi hartat topografike	7 orë
<b>Tema 3</b>	Matja e këndeve	6 orë
<b>Tema 4</b>	Matja e largësive	3 orë
<b>Tema 5</b>	Matja e sipërfaqeve	3 orë

<b>Tema 6</b>	Pozicioni në plan i sipërfaqes së tokës	4 orë
<b>Tema 7</b>	Pozicioni në lartësi i pikave të sipërfaqeve të tokës	6 orë
<b>Tema 8</b>	Relevimi takeometrik	4 orë

#### 4. Lënda “Silvikulturë” (L-25-230-11) Kl. 12 - 72 orë

- **Synimet e lëndës “Silvikulturë”, kl. 12 – 72 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Silvikulturë” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë ndikimin e elementëve klimatik në jetën e grumbullit pyjorë.
- Të shpjegojnë ndikimin e pyllit mbi klimën.
- Të përcaktojnë llojet e humusit dhe karakteristikat e tyre.
- Të përcaktojnë mënyrat e ripërtëritjes së pyllit.
- Të dallojnë etapat nga fazat e zhvillimit të pyllit.
- Të përcaktojnë zonat fitoklimatike.
- Të dallojnë format e mbarështimit të pyjeve.
- Të përcaktojnë trajtimet në trungjishte.
- Të dallojnë variantet e trajtimeve në cungjishte.
- Të përcaktojnë mënyrat e shndërrimit të pyjeve.
- Të zbatojnë trajtime në pyje.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Silvikulturë”, kl. 12 - 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit klimatik	14 orë
<b>Tema 2</b>	Raportet ndërmjet pyllit dhe tokës	7 orë
<b>Tema 3</b>	Ripërtëritja, rritja dhe zhvillimi i pyllit	9 orë
<b>Tema 4</b>	Shpërdarja e bimësisë	5 orë
<b>Tema 5</b>	Mbarështimi dhe trajtimi i pyjeve	3 orë
<b>Tema 6</b>	Trajtimi i trungjishteve	10 orë
<b>Tema 7</b>	Trajtimi i cungjishteve	7 orë
<b>Tema 8</b>	Trajtimi i cungjishtes të përbërë	5 orë
<b>Tema 9</b>	Zbatimi i trajtimeve në pyjet e vendit tonë	12 orë

#### 5. Lënda “Mbarështim pyjor” (L-25-279-12) kl. 12 - 72 orë

- **Synimet e lëndës “Mbarështim pyjor”, kl. 12 – 72 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbarështim pyjor” kl, 12, nxënësit duhet:

- Të përcaktojnë parimet bazë të mbarështimit të pyjeve.
- Të klasifikojnë pyjet sipas funksioneve të tyre.
- Të ndajnë ekonominë pyjore në parcela dhe nën/parcels.
- Të dallojnë vetitë strukturore që ndryshojnë në parcelë
- Të përshkruajnë stacionin pyjor dhe grumbullin pyjor.
- Të përcaktojnë format e shfrytëzimit.
- Të listojnë metodat që përdoren në përcaktimin e shfrytëzimit.
- Të përcaktojnë ndryshimet ndërmjet fondit të prodhimit real dhe normal.

- Të llogaritin ciklin e prodhimit.
- Të ndajnë ciklin në periudha.
- Të përcaktojnë metodat e mbarështimit në forma të ndryshme regjimesh.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbarështim pyjorë”, kl. 12 - 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për mbarështimin e pyjeve.	11 orë
<b>Tema 2</b>	Elementet tekniko-ekonomik të mbarështimit të pyjeve	9 orë
<b>Tema 3</b>	Format e metodat e shfrytëzimit të pyjeve	13 orë
<b>Tema 4</b>	Njohuri të përgjithshme për fondin e prodhimit.	13 orë
<b>Tema 5</b>	Njohuri të përgjithshme për ciklin e prodhimit.	6 orë
<b>Tema 6</b>	Mbarështimi i trungjishteve të rregullta	11 orë
<b>Tema 7</b>	Mbarështimi i trungjishteve kopshtore	6 orë
<b>Tema 8</b>	Mbarështimi i cungjishteve	3 orë

**6. Lënda “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor” (L-25-280-12). Kl. 12– 2orë dhe kl.13-68 orë**

• **Synimet e lëndës “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor ”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përcaktojnë pjesët kryesore të motoargonos dhe të autovinçit.
- Të përshkruajnë rolin e secilës gjatë punës.
- Të vendosin në punë motoargonon dhe autovinçit gjatë punës në pyll.
- Të zgjedhin veglat e thjeshta dhe ndihmëse për heqjen e lëvres.
- Të përdorin vegla të thjeshta për heqjen e lëvres në drurët pyjorë.
- Të listojnë tipet e teleferikëve dhe llojet e tyre.
- Të listojnë pjesët përbërëse të zbritësit të thjeshtë.
- Të përcaktojnë pjesët kryesore të një stacioni ndërmjetës dhe kavaletat.
- Të përshkruajnë funksionin e çdo pjese të teleferikut dhe sidomos zbritësin e thjeshtë.
- Të vizatojnë një skemë teleferiku dhe trasenë e tij në një sipërfaqe pyjore .
- Të ndërtojnë trasenë e një zbritësi të thjeshtë në terren.
- Të masin me teodolit dhe nivelues për të ndërtuar trasenë e teleferikut .
- Të përshkruajnë fazat e shfrytëzimit të pyllit si procese silvo-biologjike .
- Të lexojnë planin e mbarështimit të një sipërfaqeje pyjore .
- Të përcaktojnë metodat e shfrytëzushmërisë së sipërfaqes pyjore.
- Të përcaktojnë punimet përgatitore dhe ndihmëse për shfrytëzimin e pyjeve.
- Të realizojnë damkimin e drurëve që do të shfrytëzohen.
- Të presin dhe të asortojnë trupat sipas planit të mbarështimit .
- Të përcaktojnë asortimente që dalin realisht në pyll dhe të vlerësojnë masën drusore.
- Të pastrojnë sipërfaqen e punuar dhe të dorëzojnë atë.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor” kl, 12- 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Motoorganot, autovinçat për transportin e lëndës drusore.	11 orë
<b>Tema 2</b>	Veglat e thjeshta dhe ndihmëse për heqjen e lëvoves.	4 orë
<b>Tema 3</b>	Teleferikët, pjesët përbërëse, stacionet e ndërmjetme, kavaletat.	13 ore
<b>Tema 4</b>	Studimi projektimi dhe trasimi i një linje teleferiku.	8 orë
<b>Tema 5</b>	Shfrytëzimi i pyjeve si procese natyrore silvo-ekonomike	12 orë
<b>Tema 6</b>	Punimet përgatitore dhe ndihmëse të shfrytëzimit të pyjeve	8 orë
<b>Tema 7</b>	Prerja, përpunimi i pjesëshëm dhe asortimi i drurit në pyll	16 orë

- **Synimet e lëndës “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor” kl, 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji e shfrytëzimit pyjor”, klasa 13-të nxënësit duhet :

- Të zgjedhin transportin e brendëshëm në një sipërfaqe pyjore.
- Të përshkruajnë karakteristikat kryesore të tokës, terrenit, rrugëve dhe pistave.
- Të përcaktojnë vendet e depozitimit për depozitimin e materialit drusor.
- Të zgjedhin tipet e transportit të brendëshëm të materialit drusor me krahë, me kafshë pune dhe me lugje .
- Të organizojnë punën dhe të llogarisin prodhimtarinë në transportin e brendëshëm.
- Të sistemojnë, të stivojnë dhe të marrin në dorëzim materialin drusor.
- Të përzgjedhin tipet e skelave të depozitimit të materialit drusor dhe mënyrat e ndryshme të ngarkimit të materialit drusor .
- Të përcaktojnë bimët tanifere dhe ato me përmbajtje vaji eterik
- Të përdorin mjetet dhe mekanizmat për transportin e brendëshëm në pyje.
- Të zgjedhin mënyrat e shfrytëzimit të prodhimeve të dyta drusore dhe jo drusore
- Të realizojnë grumbullimin e rrëshirës, nxjerrjen e kollofonit dhe terpentinës.
- Të grumbullojnë kërpudhat e ngrënshme dhe t’i trajtojnë ato.
- Të përzgjedhin teknikat e shfrytëzimit të shelgishteve dhe thuprave të llojeve dhe cilësive të ndryshme.
- Të grumbullojnë llojet kryesore të frutave pyjorë dhe vlerat ushqimore të tyre.

- **Përmbajtja e përgjithëshme e lëndës “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor “, Kl. 13–68 orë.**

Tema 1	Transporti i brendëshëm në parcela pyjore	18 orë
Tema 2	Depozitimi dhe ngarkimi i drurit	18 ore
Tema 3	Organizimi i punimeve ne shfrytezimin pyjor	16 orë
Tema 4	Shfrytëzimi i prodhimeve drusore dhe jo drusore	16 orë

## **7. Lënda “Infrastruktura e shfrytëzimit pyjor” (L-25-281-12) kl, 13- 68 orë**

- **Synimet e lëndës “Infrastruktura e shfrytëzimit pyjor ”, kl, 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Infrastruktura e shfrytëzimit pyjor”, kl,13 nxënësit

duhet:

- Të përcaktojnë linjat e grumbullimit dhe të transportit të brendëshëm të materialit drusor të prerë.
- Të përdorin sisteme të ndryshme transporti në parcelat pyjore.
- Të zgjedhin operacionet e manipulimit dhe të ngarkimit në sheshet e depozitimit dhe qëndrat tranzit.
- Të përshkruajnë rrugën auto.
- Të optimizojnë distancat e transportit të brendëshëm dhe të largët të materialit drusor .
- Të përdorin tipe të ndryshme mjetesh që shërbejnë në transportin e largët.
- Të përdorin treguesit tekniko-ekonomik të tyre.
- Të përdorin një plan mbarështrimi.
- Të lexojnë planin e mbarështrimit .
- Të përdorin të dhënat e planit të mbarështrimit për hartimin e planit tekniko- ekonomik të shfrytëzimit pyjor.
- Të hartojnë një plan shfrytëzimi të pyjeve.
- Të përzgjedhin një nga skemat teknologjike në situata konkrete shfrytëzimi.
- Të llogarisin koston përfundimtare të produkteve pyjore.
- Të mbrojnë mjedisin nga shfrytëzimi pyjor dhe gjatë punës në parcela.
- Të zbatojnë masa zbutëse në ndikimin ndaj mjedisit.
- Të kryejnë punime për sigurimin e ripërtëritjes natyrore.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Infrastruktura e shfrytëzimit pyjor”, kl. 13-68 ore :**

<b>Tema 1</b>	Infrastruktura e shfrytëzimit pyjor	18 orë
<b>Tema 2</b>	Infrastruktura në shërbim të shfrytëzimit të pyjeve	12 orë
<b>Tema 3</b>	Projektimi i punimeve në shfrytëzimin pyjor	24 orë
<b>Tema 4</b>	Shfrytëzimi i pyjeve dhe ndikimi i tij në mjedisin pyjor	14 orë

## **8. Lënda “Pyllëzime artificiale” ( L-25-282-12), kl. 13 - 34 orë**

- **Synimet e lëndës “Pyllëzime artificiale”, kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Pyllëzime artificiale” kl,13 nxënësit duhet :

- Të shpjegojnë zgjedhjen e llojeve në pyllzim.
- Të shpjegojnë teknikat në pyllzime artificiale sipas zonave klimatike.
- Të përcaktojnë dendësitë e mbjelljes sipas formave të përdorura.
- Të rendisin përzierjet sipas zonave e territoreve.
- Të përshkruajnë teknikën e mbjelljes së fidanit.
- Të rendisin shërbimet që bëhen në mirëmbajtje të kulturave.
- Të shpjegojnë arsyet e ngritjes së brezave pyjorë.
- Të projektojnë punimet në mbjelljen e fidanave në anët e rrugëve auto.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pyllëzime artificiale”, kl. 13 – 34 orë.**

<b>Tema 1</b>	Rëndësia e zgjedhjes së llojeve	2 orë
<b>Tema 2</b>	Teknika e pyllëzimit	4 orë

<b>Tema 3</b>	Dëndësia, përzierja, vendosja e kulturave pyjore	3 orë
<b>Tema 4</b>	Pyllzimi me fidanë	3 orë
<b>Tema 5</b>	Pyllzimi me kalem e shpatulla	2 orë
<b>Tema 6</b>	Mirëmbajtja e kulturave	2 orë
<b>Tema 7</b>	Pyllzime në toka të pyllzuara	4 orë
<b>Tema 8</b>	Pyllzime në raste të vecanta	2 orë
<b>Tema 9</b>	Kulturat pyjore halore	4 orë
<b>Tema 10</b>	Kulturat fletore përgjithsime	4 orë
<b>Tema 11</b>	Aspekte të TIK-ut në biznesin e pyllëzimeve artificiale	4 orë

### **9. Lënda "Ligjshmëri pyjore" (L-25-236-11 ), kl. 13 – 34 orë**

- **Synimet e lëndës "Ligjshmëri pyjore", kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Ligjshmëri pyjore", klasa 13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë funksionet e menaxhimit të shërbimit pyjor.
- Të klasifikojnë pronësinë e fondit pyjor kombëtar dhe kadastrën kombëtare.
- Të rendisin funksionet e policisë pyjore.
- Të përshkruajnë fondin pyjor privat dhe pyjet në mbrojtje të vecantë.
- Të konceptojnë dispozitat ligjore mbi trajtimin e kullotave dhe livadheve.
- Të përshkruajnë legjislacionin mbi ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit.
- Të konceptojnë legjislacionin mbi peshkimin , akuakulturën dhe ushtrimin e gjuetisë.
- Të përshkruajnë dokumentacionin e veprimtarisë kontrolluese të policisë pyjore.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Ligjshmëri pyjore", kl. 13 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Pyjet dhe shërbimi pyjor, dispozitat e përgjithshme	12 orë
<b>Tema 2</b>	Fondi pyjor, kullotat dhe livadhet	6 orë
<b>Tema 3</b>	Kuadri ligjor, mbrojtja e natyrës dhe zonat e mbrojtura	6 orë
<b>Tema 4</b>	Fauna dhe gjuetia	6 orë
<b>Tema 5</b>	Dokumentacioni dhe procedurat e veprimtarisë kontrolluese të policisë pyjore	4 orë

### **10. Lënda "Mbrojtje natyre dhe planifikim territori", (L-25-234-11), kl. 13 – 34 orë**

- **Synimet e lëndës "Mbrojtje natyre dhe planifikim territori", kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Mbrojtje natyre dhe planifikim territori", kl. 13 nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë qëllimin dhe objektivat e mbrojtjes mjedisore
- Të shpjegojnë format e ndryshme të përdorimit të tokës.
- Të shpjegojnë punën që duhet bërë për mbrojtjen e jetës së egër.
- Të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit të territorit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit dhe implementimit të territorit në lidhje me mbrojtjen e natyrës.



- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbrojtje natyre e planifikim territori”, kl.13 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Objekti, rëndësia e mbrojtjes së mjedisit e planifikimit të territorit.	4 orë
<b>Tema 2</b>	Mbrojtja e natyrës e përdorimi i tokës.	6 orë
<b>Tema 3</b>	Zonat e banuara e minierat e hapura.	3 orë
<b>Tema 4</b>	Mbrojtja e llojeve, ruajtja e jetës së egër.	8 orë
<b>Tema 5</b>	Estetika e territorit dhe mbrojtja e mjedisit	3 orë
<b>Tema 6</b>	Qëllimi dhe objektivat e planifikimit të territorit	3 orë
<b>Tema 7</b>	Detyrat e planifikimit të territorit	4 orë
<b>Tema 8</b>	Njerëzit, autoritetet, institucionet që merren me planifikimin e territorit	3 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Punime me instrumenta matës gjeodezie”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Shfrytëzim pyjesh  
Niveli: III  
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME ME INSTRUMENTA MATES GJEODEZIE	M-25-646-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në përdorimin e instrumentave matës të gjeodezisë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “PYJE”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi përcakton pikat e poligonit në terren.</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgimi i zonës që do rilevohet .</li><li>– Përcaktimi i vëndit të pikave të poligonit.</li><li>– Përpilimi i skicës së zonës.</li><li>– Përcaktimi i grupit të punës që do rilevojë.</li><li>– Zgjedhja e mjeteve matëse dhe të punës.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të pikave të poligonit</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të vëzhgojë zonën që do rilevohet.</li><li>– të përcaktojë vendin e pikave të poligonit.</li><li>– të përpilojë skicat e zonës.</li><li>– të përcaktojë grupin e punës që do rilevojë.</li><li>– të zgjidhë mjetet matëse dhe të punës.</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të pikave të poligonit</li></ul>	

## **RM 2 Nxënësi mat brinjët dhe këndet e poligonit.**

### ***Përmbajtja:***

- Matja e brinjëve të poligonit në vajtje.
- Matja e brinjëve të poligonit në ardhje.
- Drejtimi i zhalonit gjatë matjes së brinjëve.
- Plotësimi i tabelës së matjeve në lartësi.
- Matja e këndeve të brëndëshëm të poligonit me Teodolit me saktësi 1 gradë.
- Përcaktimi i metodave të matjes së këndeve me një sasi të plotë.
- Matja e këndeve me dy pozicione dylbije.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së brinjëve dhe këndeve

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë brinjët e poligonit në vajtje.
- të matë brinjët e poligonit në ardhje.
- të drejtojë zhalonin gjatë matjes së brinjëve.
- të plotësojë tabelën e matjeve në lartësi.
- të masë kënde e brëndëshme të poligonit me teodolit.
- të përcaktojë metodat e matjes së këndeve .
- të matë këndet në dy pozicione dylbije.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së brinjëve dhe këndeve.

## **RM 3 Nxënësi kryen punime nivelimi të pikave të poligonit.**

### ***Përmbajtja:***

- Zgjedhja e instrumentit nivelues.
- Përgatitja e niveluesit për punë.
- Nivelimi i pikave të poligonit duke përdorur metodën gjeodezike nga mesi.
- Plotësimi i librezave të nivelimit.
- Trasferimi i kuotës së pikës vajtje-ardhje.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë nivelimit të pikave të poligonit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë instrumentin nivelues.
- të përgatisë niveluesin për punë.
- të nivelojë pika të poligonit duke përdorur metodën gjeodezike nga mesi.
- të plotësojë librezën e nivelimit.

- të trasferojë kuotën e pikës vajtje - ardhje.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë nivelimit të pikave të poligonit.

#### **RM 4 Nxënësi kryen punime dhe matje në çdo pikë qëndrimi.**

##### ***Përmbajtja:***

- Caktimi i grupit të nivelimit.
- Përcaktimi i detyrave të anëtarëve të grupit.
- Vendosja e teodolitit në pe plumç.
- Vendosja e latave në pikat e qëndrimit..
- Matja e lartësisë për çdo pikë qëndrimi ( 4 pika)
- Orientimi i instrumentit matës.
- Marrja e pikave me detaje .
- Kryerja e leximit në lartësi.
- Kontrolli i punimeve për çdo pikë qëndrimi.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve dhe matjeve në pika qëndrimi.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të caktojë grupin e nivelimit.
- të përcaktojë anëtarët e grupit.
- të vendosë teodolitin në pozicion pune .
- të vendosë latat në pikat e qëndrimit.
- të masë lartësitë për çdo pikë qëndrimi.
- të orientohet me instrumentin matës.
- të matë pikat me detaje.
- të kryejë lexime në lartësi.
- të kontrollojë punimet për çdo pikë qëndrimi.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve dhe matjeve në pika qëndrimi.

## **RM 5 Nxënësi kryen hedhje të pikave në planshetë në zyrë**

### ***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i letrës së vizatimit dhe mjeteve.
- Vendosja e pikave të qëndrimit në letrën e vizatimit me kordinatë ose raportor.
- Vendosja e pikave me detaje në letrën e vizatimit.
- Interpolimi i izoipseve
- Kontrolli i pikave të interpoluara.
- Vizatimi me tush i objekteve, izoipseve dhe rrjedhjeve ujore.
- Plotësimi i kornizës së planshetës.
- Matja e sipërfaqes së zonës me planimetër polar

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë llojin e letrës së vizatimit .
- të vendosë në leter pikat e qëndrimit me kordinatë ose raportor.
- të vendosë pikat me detaje në letrën e vizatimit.
- të realizojë interpolimin e izoipseve.
- të kontrollojë pikat e interpoluara.
- të vizatojë me tush objektet, izoipseve dhe rrjedhjet ujore.
- të plotësojë kornizën e planshetës
- të përcaktojë sipërfaqen e zonës me planimeter polar.

---

### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të matjeve të sipërfaqeve pyjore dhe jo pyjore me Teodolit dhe nivelues, te demostroje plotesimin e tabelave të nivelimit dhe të matjeve me teodolit, te demostroje mbajtjen dhe leximin e lates në pikat e poligonit, te hedhe në planshet te dhenat e grumbulluara dhe të realizoje në zyrë mbylljen e poligonit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore, përcaktimin e sipërfaqeve pyjore për matje me teodolit dhe nivelues, përbilimin e tabelave dhe librit të nivelimit, matjen e pikave të poligonit dhe leximin me instrumenta matës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e planshetës, hedhjen e pikave të poligonit në planshete si dhe matjen e sipërfaqes me planimeter polar.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve..
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e matjeve gjeodezike në terren dhe në zyrë.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor.
  - Mjete matëse gjeodezike, teodolit e nivelues, lata, planimeter polar, meter shirit
  - Komplete veshje e puntorit ne fushen e pyjeve..
  - Hipsometer, diameter mates, latë, zhalon .
  - Tabela te gatshme për hedhjen e të dhënave te grumbulluara nga matjet.
  - Harta dhe busull orjentuese.
  - Makine llogaritëse, kanceleri te ndryshme si flete vizatimi, leter kalk etj
-

## 2. Moduli “Kubimi i grumbullit pyjor dhe drurit në këmbë”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Shfrytëzim pyjesh  
Niveli: III  
Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUBIMI I GRUMBULLIT PYJOR DHE DRURIT NE KEMBE	M-25-647-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kubimin e drurit në këmbë dhe grumbullit pyjor.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për kubimin e grumbullit pyjor.</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Analiza e grumbullit pyjor.</li><li>– Përcaktimi i sipërfaqes së grumbullit pyjor dhe fuqisë lëndore në pyll</li><li>– Ndarja e sipërfaqes në pjesë të vogla homogjene.</li><li>– Inventarizimi i pjesshëm dhe i përgjithshëm .</li><li>– Zgjedhja e metodave të kubimit të grumbullit pyjor.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të analizojë grumbullin pyjor.</li><li>– të përcaktojë sipërfaqen e grumbullit pyjor dhe fuqinë lëndore në pyll.</li><li>– të ndajë sipërfaqen në pjesë homogjene.</li><li>– të realizojë inventarizimin e pjesshëm dhe të përgjithshëm.</li><li>– të zgjedhë metodat e kubimit.</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së vendit të punës</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi kubon drurin në këmbë.</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përcaktimi i sipërfaqes pyjore.</li></ul>	

- Zgjedhja e drurëve që do kubohen.
- Matja e diametrit të drurit në lartësinë 1,30m nga toka.
- Matja e lartësisës së drurit me hipsometer.
- Llogaritja e vëllimit të drurit.
- Nxerrja e koeficientit të formës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të drurit më këmbë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë sipërfaqet pyjore për kubimin e drurit.
- të zgjedhë drurët që do kubohen.
- të matë diametrin e drurit në lartësinë 1,30m.
- të matë lartësinë me hipsometër.
- të llogaritë vëllimin e drurit.
- të nxjerrë koeficientin e formës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të drurit në këmbë.

**RM 3 Nxënësi kubon grumbullin pyjor me sipërfaqe provë e prerje rrah.**

***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i sipërfaqes së grumbullit pyjor.
- Përcaktimi i përqindjes së inventarizimit.
- Zgjedhja e sipërfaqes provë.
- Përcaktimi i madhësisë së sipërfaqeve provë.
- Zgjedhja e formave të sipërfaqeve provë .
- Piketimi i sipërfaqes provë.
- Kubimi i sipërfaqes provë të grumbullit pyjor.
- Hedhja e të dhënave në tabelat e kubimit dhe llogaritja e vëllimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të grumbullit pyjor me sipërfaqe provë

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë sipërfaqet e kubimit të grumbullit pyjor .
- të përcaktojë përqindjen e inventarizimit.
- të zgjedhë sipërfaqen provë.
- të përcaktojë madhësinë e sipërfaqes provë.
- të zgjedhë formën e sipërfaqes provë.
- të piketojë sipërfaqen provë.
- të kubojë sipërfaqen provë dhe grumbullin pyjor.



- të hedhë të dhënat në tabelat e kubimit dhe të llogarisë vëllimin e grumbullit pyjor.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të grumbullit pyjor me sipërfaqe provë

**RM 4 Nxënësi kubon drurin me inventarizim , pa drurë mesatarë.**

***Përmbajtja***

- Përcaktimi i sipërfaqes së kubimit të grumbullit.
- Matja e diametrave të drurëve .
- Matja e lartësisë së drurëve
- Hartimi i list-damkave të sipërfaqes pyjore të zgjedhur.
- Ndërtimi i kurbës së lartësisë së kompesuar.
- Llogaritja e vëllimit për njësi .
- Llogaritja e vëllimit të përgjithshëm.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës.

***Instrumenti i vëzhgimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit :***

Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- të përcaktojë sipërfaqen e kubimit të grumbullit.
- të masë diametrat e drurit
- të masë lartësitë e drurëve.
- të hartojë listë- damkën e sipërfaqes së kubimit.
- të hartojë kurbën e lartësisë së kompesuar.
- të llogarisë vëllimin për njësi .
- të llogarisë vëllimin e përgjithshëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të drurit me inventarizim

**RM 5 Nxënësi kubon grumbullin pyjor me inventarizim me drurë model.**

***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i sipërfaqes pyjore të kubimit .
- Inventarizimi i diametrave .
- Përcaktimi i drurëve model(diametri mesatar).
- Zgjedhja në terren e drurit model.
- Përcaktimi i numrit të drurëve modele.
- Kubimi i drurit model.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë sipërfaqet pyjore për kubimin e grumbullit

- të inventarizojë diametrat e grumbullit pyjor.
- të përcaktojë drurët model .
- të zgjedhë në terren drurin model.
- të përcaktojë numrin e drurit model.
- të llogaritë kubimin e drurit model.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kubimit të grumbullit pyjor

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në klasë, pranë drejtorive të shërbimit pyjor në rreth, si dhe në biznese private në fushën e pyjeve .
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të llogaritjeve ekonomike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve praktike për llogaritje të thjeshta ekonomike të hartimit të një plan biznesi për prodhimin e asortimenteve të drurit, për prodhimin e rëshirës, kollofanit dhe terpentinë, për prodhimin e këpurdhave, për prodhimin e bimëve eterovajore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të plotësimit dokumentacionit të nevojshëm, ruajtjen e dokumentacionit të nevojshëm, analizën e këtyre dokumentacioneve dhe nxjerrjen e konkluzioneve të rëndësishëm financiar.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të ndryshme për realizimn e llogaritjeve të thjeshta ekonomike përcaktimin e cmimit , të koston dhe fitimit të çdo produkti të përmendur më sipër.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Modele projektesh te aplikuar ne fushën e pyjeve.
  - Pajisje kancelarie.
  - Interneti
  - Makina llogaritëse dore.
  - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e koston.
  - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e pyjeve që lidhet me prodhimet pyjore(kodi i punës, legjislacioni fiskal).
  - Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal.
-

## 10. Moduli “Ruajtja dhe ekonomizimi i materialit drusor”

**Drejtimi:** Pyje  
**Profili:** Shfrytëzim pyjesh  
**Niveli:** III  
**Klasa:** 13

### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>RUAJTJA DHE EKONOMIZIMI I MATERIALIT DRUSOR</b>	<b>M-25-837-12</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në ekonomizimin e ruajtjen e materialit drusor gjatë transportit dhe depozitimit.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	48 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Shfrytëzim pyjesh”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësi merr në dorëzim asortimentet drusore në sheshe depozitimi.</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përgatitja e shesheve të depozitimit ose skelave.</li><li>– Matja e vëllimit të lëndës punuese në m3.</li><li>– Përcaktimi i sipërfaqeve të shesheve të depozitimit.</li><li>– Matja e vëllimit të druve të zjarrit në m3.</li><li>– Matja e gjatësisë së trupave dhe diametri në mesin e tyre.</li><li>– Shënimi i diametrit dhe gjatësisë në kokat e trupave.</li><li>– Shënimi me bojë ose me gëlqere i drurëve të zjarrit.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të përgatisë sheshet e depozitimit dhe skelat për të grumbulluar materialin.</li><li>– të përcaktojë sipërfaqet e shesheve të depozitimit.</li><li>– të llogarisë vëllimin e lëndës së punimit në m3.</li><li>– të matë gjatësinë dhe diametrin në mesin e trupit.</li><li>– të shënojë në kokat e trupave dhe të lëndës së ndërtimit diametrin dhe gjatësinë e tyre.</li><li>– të shënojë drutë e zjarrit me bojë ose gëlqere.</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për depozitimin e materialit.</li></ul>	

## **RM 2 Nxënësi mbron drurët e prerë nga dëmtuesit gjatë qëndrimit në depozitë.**

### ***Përmbajtja:***

- Zgjedhja e metodave të ruajtjes dhe mbrojtjes së lëndës.
- Zbatimi i metodës së zgjedhur në varësi të asortimentit.
- Përdorimi i metodës së njomë për trupat e ahut, kompesatos dhe trupat e sharrës.
- Përdorimi i spërkatjes së trupave me ujë.
- Lyerja e trupave të porsaprerë me pasta .
- Përdorimi i mënyrës së thatë në trupat për lëndë ndërtimi shtylla telefoni etj.
- Stivimi i materialit drusor sipas kushteve të përcaktuara.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë metodat efikase për mbrojtjen e drurit.
- të zbatojë metodat e përzgjedhura me shume korrektësi në varësi të asortimentit.
- të përdorë metodën e njomë të ruajtjes së materialit.
- të përdorë metodën e thatë për lëndë ndërtimi, shtylla miniere, shtylla telefoni etj.
- të përdorë metodën e ruajtjes me spërkatje të trupave.
- të lyejë trupat e porsa prerë me pasta të ndryshme për mbrojtjen e tyre nga dëmtuesit
- të stivosë materialin sipas kushteve teknike të përcaktuara.
- të pastrojë, të mirëmbajë dhe të sistemojë mjetet e punës që ka përdorur.
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbrojtjes së materialit të depozituar

## **RM 3 Nxënësi shfrytëzon drurin në mënyrë racionale**

### ***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i humjeve në shfrytëzimin e pyjeve.
- Regjistrimi i humjeve gjatë prodhimit të asortimenteve pyjore.
- Regjistrimi i humbjeve gjatë prodhimit të asortimenteve
- Regjistrimi i humjeve gjatë transportit të brendëshëm.
- Llogaritja e vëllimit të humjeve në cung.
- Llogaritja e vëllimit të humjeve në drurët e hollë dhe të vegjël.
- Llogaritja e humjeve nga heqja e lëvores.
- Përcaktimi i humbjeve për lëndën e punimit.
- Përcaktimi i humjeve për drutë e zjarrit.

- Zgjedhja e mjeteve për shfrytëzimin sa më racional të pyllit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë shfrytëzimit racional të pyllit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë humjet gjatë prodhimit të asortimenteve.
- të regjistrojë humjet e transportit të brendshëm.
- të regjistrojë humjet gjatë manipulimit.
- të përdorë vëllimin e humjeve në trung.
- të përdorë humjet në drurin e hollë dhe të vogël.
- të kontrollojë humjet nga lëvorja.
- të përcaktojë humjet e lëndës së punimit.
- të përcaktojë humbjet për drutë e zjarrit.
- të përzgjedhë mjetet e domosdoshme për një shfrytëzim sa më racional .
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në shfrytëzimit pyjor

**RM 4 Nxënësi merr masa për ekonomizimin e drurit.**

***Përmbajtja:***

- Përdorimi i masave silvikulturore.
- Përdorimi me efikasitet i masave të shfrytëzimit.
- Sigurimi i dokumentacionit teknik për fondin e shfrytëzimit
- Vlerësimi i plotë i grumbujve pyjorë të dëmtuar.
- Ulja e konsumit të përdorimit të drurit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ekonomizimit të drurit

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë masat silvikulturore .
- të përdorë me efikasitet masat e shfrytëzimit të pyllit
- të sigurojë fondin teknik të shfrytëzimit.
- të vlerësojë grumbullin pyjor të dëmtuar.
- të ulë konsumin e materialit drusor pa kriter.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ekonomizimit të drurit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në parcelat dhe nën parcelat pyjore.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të depozitimit në sheshe dhe skela depozitimi të materialit të shfrytëzuar në të



---

gjithë asortimentet.

- Instruktori duhet të realizojë praktikisht ruajtjen dhe mbrojtjen e drurit nga dëmtimet me metodën e njomë, të thatë etj.
- Instruktori duhet të realizojë praktikisht format dhe menyrat e ekonomizimit të drurit dhe përcaktimin e llojeve të ndryshme të humjeve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje konkrete të humjeve në asortimenteve të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në matjen e diametrave dhe të lartësive të drurit për përcaktimin e vëllimit të materialit drusor.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për ekonomizimin e drurit dhe uljen e konsumit të materialit drusor.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis pune shfrytëzimi.
  - Mjetet, instrumentet matëse diametri dhe lartësie të drurit..
  - Komplet i veshjes së punëtorit.
  - Skela të gatshme për transportimin e drurit..
  - Sheshe depozitimi në parcela ose nën/parcelsa.
  - Dokumentacion teknik për fondin pyjor.
  - Rezervuar uji për mbrojtjen e drurit,
  - Spërkatës për spërkatjen e drurit.
  - Pasta për lyerjen e druëve në kokat e tyre.
  - Pankarta për punimet e ndryshme gjatë depozitimit dhe menyrave të depozitimit.
  - Skica të gatshme për mbrojtjen e drurit.
  - Pajisje kancelarie.
  - Makina llogaritëse dore.
  - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
-

## 11. Moduli “Punime përgatitore në rrugët pyjore”

**Drejtimi:** Pyje  
**Profili:** Shfrytëzim pyjesh  
**Niveli:** III  
**Klasa:** 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIME PËRGATITORE NË RRUGËT PYJORE</b>	<b>M-25-838-12</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese pune për punimet përgatitore në rrugët pyjore.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	48 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Shfrytëzim pyjesh”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi përcakton në terren elementët ndërtimor të rrugës.</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Punime operatore të bazuara mbi të dhënat e objektit.</li><li>– Rikontrolli i boshtit të rrugës së projektuar.</li><li>– Plotësimi i piketave që mungojnë.</li><li>– Kryerja e punimeve shtesë.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtës së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të përcaktojë në terren elementët ndërtimor të rrugës.</li><li>– të rikontrollojë në terren boshtin e rrugës së projektuar.</li><li>– të kontrollojë piketat që n.q.s mungojnë të zëvendësohen me reperi të palëvizshme (druri , gurë etj) .</li><li>– të bëjë punime shtesë.</li></ul>	

**RM 2 Nxënësi pastron brezin e terrenit ku do të krijohet trupi i rrugës.**

***Përmbajtja:***

- Zgjedhja e veglave të punës.
- Punime për pastrimin e sipërfaqes natyrale në gjerësinë e brezit nga bimësia vegjetative (drurë , shkurre etj) .
- Punime për pastrimin e gurëve dhe mbeturinave natyrore apo artificiale.
- Shkulja e cungjeve.
- Përgatitja e veglave të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë veglat e punës
- të bëj pastrimin e brezit të terrenit nga bimësia vegjetative.
- të pastrojë trupin e rrugës që do të krijohet nga gurët dhe mbeturinat natyrore dhe artificiale.
- të bëj shkuljen e cungjeve.
- të përgatitë veglat e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë pastrimit të terrenit

**RM 3 Nxënësi kryen profilizimin e trupit të rrugës dhe veprave të artit.**

***Përmbajtja:***

- Punime për tharjen e zonave me lagështi të madhe.
- Vendosja e reperiave në gjatësinë e platformës, pjerrësinë e skarpave.
- Shkriftimi i terreneve të forta dhe shumë të forta.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëj punime për tharjen e zonave dhe sipërfaqeve me lagështi të madhe.
- të vendosë reperet në gjatësinë e platformës dhe pjerrësinë e skarpave.
- të bëj me mjete të thjeshta shkriftimin e terreneve të forta dhe shumë të forta.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantët profesionale.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete .
- Nxënësit duhet të angazhohen me veprimtari konkrete pune. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës.
- Gjatë vlersimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes se shprehive praktike për realizimin e punimeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikua për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset e punës materialet e ndryshme dhe veglat si me mëposhtme:
- Motosegë
  - Gërshërë
  - Kazma
  - Lopata
  - Sopatë
  - Karrocë dore
  - Piketa.
  - Manualët , udhëzuesat , materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtuam në modul.
-

## 12. Moduli “Prodhimi i qymyrit të drurit”

**Drejtimi:** Pyje  
**Profili:** Shfrytëzim pyjesh  
**Niveli:** III  
**Klasa:** 13

### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PRODHIMI I QYMYRIT TE DRURIT</b>	<b>M-25-839-12</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për prodhimin e qymyrit të drurit (karbonizimin) dhe ndërtimin e kaminave të qymyrit .	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	33 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Shfrytëzim pyjesh”:	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësi kryen procese përgatitore për karbonizimin e drurit</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Analiza e fuqisë lëndore për rreth kaminës.</li><li>– Përgatitja e vatrës së kaminës.</li><li>– Sigurimi i ujit për shërbimet në kaminë.</li><li>– Përcaktimi i pajisjeve të shërbimit.</li><li>– Përgatitja e materialeve dhe veglave të punës.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të qymyrit të drurit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të analizojë fuqinë lëndore për rreth kaminës.</li><li>– të përgatisë vatrën e kaminës.</li><li>– të sigurojë ujin për shërbimet në kaminë.</li><li>– të përzgjedhë dhe të përgatisë pajisjet e shërbimit gjatë punës.</li><li>– të përzgjedhë materialet dhe veglat e punës.</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit për ndërtimin dhe prodhimin e qymyrit të drurit.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi kryen punime për vendosjen e kaminës</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Gërmimi i vatrës së kaminës.</li><li>– Krijimi i depozitës së ujit.</li><li>– Transporti i lëndës nga parcela tek kamina.</li><li>– Përgatitja e hunjve për oxhakun dhe grykën e ajrimit.</li></ul>	

- Rradhitja e lëndës drusore në vatër për procesin e karbonizimit.
- Mbulimi i kaminës me degë dhe baltë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të qymyrit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të gërmojë vatrën e kaminës.
- të ndërtojë depozitën e ujit .
- të transportojë lëndën nga parcela deri tek kamina.
- të përgatisë hunjtë për oxhakun dhe grykën e oxhakut.
- të rradhitë lëndën drusore në vatër për procesin e karbonizimit.
- të mbulojë kaminën me degë dhe baltë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të qymyrit të drurit.

**RM 3 Nxënësi kontrollon punimet gjatë dhe pas karbonizimit të drurit.**

***Përmbajtja:***

- Zvëndësimi i pjesëve me difekte.
- Kontrolli i kanaleve të ajrimit dhe kullimit të ujit
- Kontrolli i plasaritjeve të shtresës së baltës.
- Ndezja e kaminës
- Ndjekja e procesit të karbonizimit të drurit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë karbonizimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zëvendësojë pjesët me difekte gjatë punës
- të kontrollojë kanalet e ajrimit dhe të kullimit të ujit.
- të kontrollojë plasaritjen e shtresës së baltës.
- të ndezë kaminin
- të ndjekë procesin e karbonizimit.
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik gjatë ndezjes dhe rruajtjen e mjedisit gjatë prodhimit të qymyrit

**Udhëzime për  
zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në sheshe depozitimi afer pyjeve ,atje ku mund te sigurohen mbetjet e drurit.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të prodhimit te qymyrit , ndertimit të kaminit ,përgatitjes së hunjve , oxhakut dhe grykës së ajrimit,kontrollin e kanleve te ajrimit dhe të kullimit të ujit.ndezjen e kaminës , ndjekjen e proçesit të karbonizimit dhe nxjerrjen jashtë të qymyrit të drurit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për ndërtimin e kaminës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në grumbullimin e materialit per djegje..
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve gjatë punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e prodhimit të qymyrit të drurit .

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Vegla dore, lopata ,kazëm,sëpatë,motosharra,sqeparë,vare.kova uji,mjete transporti.
  - Lende ndezese, shufra hekuri etj.
  - Terren te përshtatshëm per ndertimin e kaminit.
  - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese.
  - Komplet i veshjes së puntorit .
  - Materialet për ndertimin e kaminit si balte ,thupra etj.
  - Skela të gatshme

### 13. Moduli “Punimet në inventarizimin e pyjeve - 2”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Shfrytëzim pyjesh  
Niveli: III  
Klasa: 13

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NË INVENTARIZIMIN E PYJEVE - 2	M-25-654-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet në inventarizimin e pyjeve.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Shfrytëzim pyjesh”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi zbaton metodat e matjes në trungjishtet e rregullta.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përcaktimi i metodës së matjes (me sipërfaqe provë).</li><li>– Llogaritja e numrit të sipërfaqeve provë që do të merren në ekonomine pyjore.</li><li>– Përcaktimi i madhësisë së sipërfaqeve provë.</li><li>– Përcaktimi i vendit ku do të merren sipërfaqet provë.</li><li>– Inventarizimi i drurëve brenda sipërfaqes provë.</li><li>– Matja e diametrit në lartësinë 1.30 cm nga toka.</li><li>– Matja e lartësisë së drurëve.</li><li>– Përcaktimi i moshës së drurëve.</li><li>– Hedhja e të dhënave në fletën e inventarizimit.</li><li>– Llogaritja e diametrit mesatar, lartësisë mesatare, moshës mesatare të drurëve të sipërfaqes provë.</li><li>– Plotësimi i tabelave të fuqisë lëndore.</li><li>– Llogaritja e fuqisë lëndore.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të përcaktojë metodën e matjes në trungjishtet e rregullta.</li><li>– të llogaritë numrin e sipërfaqeve provë që do të merren në ekonominë pyjore.</li><li>– të përcaktojë madhësinë e sipërfaqeve provë.</li><li>– të përcaktojë vendin ku do të merren sipërfaqet provë.</li><li>– të inventarizojë drurët brenda sipërfaqeve provë.</li></ul>	



- të masë diametrin e drurëve në lartësi 1.30 cm nga toka.
- të masë lartësinë e drurëve.
- të përcaktojë moshën e drurëve.
- të hedhë të dhënat e matjeve në fletën e inventarizimit.
- të llogarisë dm, Hm dhe Mm të drurëve të sipërfaqes provë.
- të plotësojë tabelat e fuqisë lëndore.
- të llogarisë fuqinë lëndore të sipërfaqes provë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të matjeve në trungjishte

## **RM 2 Nxënësi zbaton metodat e matjes në trungjishtet kopshtore.**

### ***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i metodës së matjes (me sipërfaqe provë).
- Llogaritja e numrit të sipërfaqeve provë që do të merren në ekonomine pyjore.
- Përcaktimi i madhësisë së sipërfaqeve provë.
- Përcaktimi i vendit ku do të merren sipërfaqet provë.
- Inventarizimi i drurëve me diametër 6 cm e lart brenda sipërfaqes provë.
- Udhëzime për inventarizimin e drurëve 6-10 cm pa llogaritur fuqinë lëndore.
- Matja e diametrit në lartësinë 1.30 cm nga toka të drurëve mbi 10 cm.
- Matja e lartësisë së drurëve mbi 10 cm.
- Përcaktimi i moshës së drurëve.
- Hedhja e të dhënave në fletën e inventarizimit.
- Llogaritja e diametrit mesatar, lartësisë mesatare, moshës mesatare të drurëve të sipërfaqes provë.
- Llogaritja e vëllimit të drurëve për çdo kategori diametrike.
- Llogaritja e vëllimit për Ha në trungjishtet kopshtore.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë metodën e matjes në trungjishtet e kopshtore.
- të llogaritë numrin e sipërfaqeve provë që do të merren në ekonominë pyjore.
- të përcaktojë madhësinë e sipërfaqeve provë.
- të përcaktojë vendin ku do të merren sipërfaqet provë.
- të inventarizojë drurët me diametër 6 e lart brenda sipërfaqeve provë.
- të zbatojë udhëzimin që drurëve 6-10 cm të mos u llogaritet fuqia lëndore.

- të matë lartësinë e drurëve.
- të matë diametrin e drurëve në lartësi 1.30 cm nga toka.
- të përcaktojë moshën e drurëve.
- të hedhë të dhënat e matjeve në fletën e inventarizimit.
- të llogarisë dm, Hm dhe Mm të drurëve të sipërfaqes provë.
- të llogaritë vëllimin e drurëve për çdo kategori diametrike.
- të llogaritë vëllimin për Ha të trungjishteve kopshtore.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë matjeve në trungjishte kopshtore

### **RM 3 Nxënësi zbaton metodat e matjes në cungjishte.**

#### ***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i numrit të sipërfaqeve provë.
- Përcaktimi i madhësisë së sipërfaqeve provë.
- Përcaktimi i vendit ku do të merren sipërfaqet provë.
- Prerja e gjithë drurëve me prejardhje llastarore brenda sipërfaqes provë
- Prerja e drurëve të prerë në gjatësi standart 1m.
- Stivosja e drurëve në stiva.
- Matja e vëllimit në ms.
- Kthimi i vëllimit në m<sup>3</sup> duke u shumëzuar me koeficientin e stivimit.
- Plotësimi i tabelës me fuqitë lëndore të cungjishteve për dru zjarri.
- Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë numrin e sipërfaqeve provë.
- të përcaktojë madhësinë e sipërfaqeve provë.
- të përcaktojë vendin ku do merren sipërfaqet provë.
- të presë brenda sipërfaqes provë të gjithë drurët me prejardhje farore.
- të presë drurët në gjatësi standart 1m.
- të stivosë drurët në stiva.
- të matë vëllimi në ms.
- të kthejë vëllimin në m<sup>3</sup> duke e shumëzuar me koeficientin e stivimit.
- të plotësojë tabelën e fuqisë lëndore të cungjishteve për dru zjarri.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë matjeve në cungjishte

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë në zonë pyjore
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer inventarizime në pyjet fletorë dhe halorë
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në inventarizimin e pyjeve fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në inventarizimin e pyjeve, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e këtyre proceseve, si dhe plotësimin e formularëve.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Ekonomi pyjore për të kryer inventarizimin e pyjeve.
  - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
  - Katalogë dhe manuale, plane inventarizimi.
-

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

### 1.Moduli “Trajtimi i pyllit për qëllime të posaçme”

Drejtimi: Pyje  
 Profili: Shfrytëzim pyjesh  
 Niveli: III  
 Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>TRAJTIMI I PYLLIT PËR QËLLIME TË POSAÇME</b>	<b>M-25-659-11</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të trajtuar pyllin për qëllime të posaçme.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	36 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer Për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësit trajtojnë pyllin për mbrojtjen e tokës nga gërryerja.</b>  <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Përcaktimi i formës së qeverisjes në pyllin me funksion mbrojtës(trungjishte)</li> <li>– Prerja e drurëve me të zgjellur(trajtimi kopshtorë).</li> <li>– Zbatimi i varjantit(prerje) me breza të këmbyer në cungjishte dhe në shkurre.</li> <li>– Përcaktimi i gjërësisë së brezit.</li> <li>– Përcaktimi i drejtimit të brezit.</li> <li>– Vlerësimi i materjalit drusore të prerë.</li> <li>– Pastrimi i pyllit nga mbeturinat.</li> <li>– Rregullimi i përzierjes së llojeve në përbërje(mbjedhje e llojeve fletorë)</li> <li>– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.</li> <li>– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e territorit.</li> </ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li> </ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b>                      Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të përcaktojnë formën e qeverisjes të pyllit me funksion mbrojtës të tokës nga gërryerja.</li> <li>– të zbatojnë trajtimin kopshtorë në trungjishte.</li> </ul>	

- të zbatojnë varjantin me breza të këmbyer në cungjishte.
- të përcaktojnë gjatësinë e brezit.
- të përcaktojnë drejtimin e brezit.
- të vlerësojnë materjalin drusorë të prerë.
- të pastrojnë pyllin nga mbeturinat.
- të rregullojnë përzierjen e llojeve me mbjedhje të llojeve fletorë.
- të theksojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

## **RM 2 Nxënësit trajtojnë zonat e gjelbërta.**

### ***Përmbajtja:***

- Heqja e drurëve të pa dëshiruar në zonat e gjelbërta (të dëmtuar, të sëmurë, të tharë etj).
- Krasitje artificiale të degëve të kurorave.
- Mbjedhje e llojeve dekorative në këto zona.
- Mbjedhje e shkurreve dekorative.
- Krasitje e kurorave të shkurreve duke i dhënë forma të ndryshme.
- Mjellje lulesh që formojnë mozaik ngjyrash.
- Mirëmbajtja e territoreve për defrime (pista sporti, kende lojrash etj.)
- Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mirëmbajtjen e mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të heqin drurët e pa dëshiruar në zonat e gjelbërta.
- të krasitin degët e kurorave.
- të mbjellin lloje dekorative në këto zona.
- të mbjellin shkurre dekorative.
- të krasitin kurorat e shkurreve duke i dhënë forma të ndryshme.
- të mbjellin lule që formojnë mozaik ngjyrash.
- të mirëmbajnë territoret që shërbejnë për defrime
- të theksojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

## **RM 3 Nxënësit trajtojnë pyjet parqe (pyje ekzistues natyrorë).**

### ***Përmbajtja:***

- Zbatimi i prerjeve kopshtore për të mbajtur të përherëshëm vegjetacionin në pyje.
- Zbatim i prerjeve sanitare në pyje parqe.
- Pastrimi i pyllit nga ferrat, e mbeturinat.
- Mjellje e llojeve të ndryshëm pyjorë për të rregulluar përbërjen e pyllit.
- Mirëmbajtja e livadheve me pastrime.

- Mbjedhje bari në sipërfaqe boshe(livadhe)
- Mbjedhje shkurre si mjet strehimi dhe ushqimi për faunën e pyllit.
- Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e territorit.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë prerjet kopshtore për të mbajtur të përhershëmvegetacionin në pyje.
- të zbatojnë prerjet sanitare në pyjet parqe.
- të pastrojnë pyllin nga ferrat dhe mbeturinat.
- të mbjellin lloje të ndryshëm pyjorë për të rregulluar përbërjen e pyllit.
- të mirëmbajnë livadhet me pastrime.
- të mbjellin barë në sipërfaqe boshe(livadhe).
- të mbjellin shkurre si mjet strehimidhe ushqimi për faunën e pyllit.
- të theksojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikatat profesionale në pyjet me funksione të posaçme.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer trajtimet në pyjet për qëllime të posaçme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në pyjet për qëllime të posaçme fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në trajtimin e pyjeve për qëllime të posaçme, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e këtyre proceseve.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Ekonomi pyjore per te kryer trajtimin e pyjeve.
  - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
  - Katalogë dhe manuale,plane mbarështimi.
-

## 2.Moduli “Shfrytëzimi i pyjeve me makina të automatizuara“

Drejtimi: Pyje  
Profili: Shfrytëzim pyjesh  
Niveli: III  
Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	<b>SHFRYTEZIMI I PYJEVE ME MAKINA TE AUTOMATIZUARA</b>	<b>M-25-840-12</b>
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit me metoda te reja dhe moderne të shfrytëzimit pyjor	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer Për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi përcakton tipet e parcelave të shfrytëzimit.</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Njohja me planin e shfrytëzimit .</li><li>– Përcaktimi i parcelave dhe nën/parcelave të cilat do shfrytëzohen.</li><li>– Përcaktimi i llojeve të transportit që do përdoren për cdo parcelë .</li><li>– Zgjedhja e mjeteve të punës gjatë shfrytëzimit</li><li>– Përcaktimi i pjerrësisë së parcelës .</li><li>– Zgjedhja e sheshit të përpunimit .</li><li>– Zgjedhja e sheshit të depozitimit të materialit.</li><li>– Përcaktimi i llojit të makinave automatike .</li><li>– Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit .</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Të zbatojnë planin e shfrytëzimit .</li><li>– Të përcaktojnë parcelat dhe nën/parcelat për shfrytëzim</li><li>– Të përcaktojnë llojet e transportit të materialit</li><li>– Të zgjedhin mjetet e punës gjatë shfrytëzimit .</li><li>– Të përcaktojnë pjerrësinë e parcelave.</li><li>– Të zgjedhë sheshin e përpunimit të materialit dhe vendosjes së makinës</li><li>– Të zgjedhë sheshin e depozitimit të materialit të asortuar të materialit .</li><li>– Të përcaktojnë llojin e makinave në varësi të terrenit .</li></ul>	

- 
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë depozitimit të materialit.
  - Të theksojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e mjedisit

**RM 2 Nxënësit vëzhgojnë punën në parcela të sheshta me makina *Harvester head John Deere H 414***

***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i pozicionit të instalimit të makines.
- Instalimi i makines në parcelën e cila do shfrytëzohet teresisht.
- Përgatitja e vendit të punës .
- Çaktimi i vendit të mbetjeve .
- Zgjedhja e sheshit të depozitimit të materjalit .
- Përcaktimi i proceseve të punës që do kryej makina.
- Çaktimi i dimensioneve të asortimenteve që do prodhohen .
- Ndarja e asortimenteve .
- Heqja e degeve dhe kurrores.
- Heqja e levoreve në rrastin e drureve halore.
- Transporti i mbetjeve në mjetet e transportit .
- Transportimi i asortimenteve në sheshet e depozitimit.
- Udhëzime për rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mirëmbajtjen e mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë pozicionin e instalimit të makines.
- Të instalojnë makinën në parcelën që do shfrytëzohet .
- Të përgatisin vendin e punës.
- Të caktojnë vendin e mbetjeve .
- Të zgjedhë sheshin e depozitimit të materjaleve.
- Të përcaktojnë proceset e punës që do kryej makina.
- Të caktohet përmasat e asortimenteve.
- Të ndaje në asortimente.
- Të heqë degët dhe kurroren.
- Të heqë levoren në druret halore.
- Të transportojë mbetjet në sheshet e mbetjeve .
- Të transportojë asortimentet në sheshet e depozitimit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 3 Nxënësit vëzhgojnë punën e makinës *AFM 60 COMBI HARVASTER HEAD ONO & K* në parcela me pjerrësi**

***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i pozicionit të instalimit të makinës.
- Instalimi i makinës në parcelën që do të shfrytëzohet.



- Përgatitja e vendit të punës.
- Zgjedhja e sheshit të depozitimit të materialeve .
- Përcaktimi i proceseve të punës që do të kryejë makina.
- Përcaktimi i asortimenteve që do prodhohen .
- Ndarja në asortimente.
- Heqja e degëve dhe kurorave .
- Heqja e lëvores në rastin kur është e domosdoshme .
- Transportimi i mbetjeve në sheshet e depozitimit të mbetjeve .
- Transportimi i asortimenteve në sheshe depozitimi.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të përcaktojnë pozicionin e instalimit të makinës.
- Të instalojnë makinën në parcelën që do të shfrytëzohet
- Të përgatisë vendin e punës për shfrytëzim
- Të zgjedhë sheshin e depozitimit të materialit .
- Të përcaktojnë proceset e punës që do kryejë makina
- Të perzgjedhë asortimentet që do prodhohen .
- Të realizojnë ndarjen në asortimente.
- Të pastrojnë degët dhe kurorën .
- Të heqë levoren në rastet kur është e domosdoshme .
- Të transportojnë në sheshet e depozitimit të mbetjeve .
- Të transportojnë asortimentet në sheshet e depozitimit.
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

Për realizimin e modulit është e domosdoshme të jenë:

- Të instaluara makina në zonat pyjore
- Instruktori i cili realizon këtë modul duhet të ketë njohuritë e domosdoshme për të dhënë këtë modul.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë demonstrime konkrete gjatë punës në parcelë.
- Instruktori duhet të angazhojë sa më shumë nxënësit në këtë proces për të punuar në mënyre të pavarur. Por duke pasur parasysh që këto tipe makinash duan specialiste është e këshillueshme që nxënësit të vëzhgojnë proceset që kryen makina.
- Instruktori të mbikqyrë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në parcelat pyjore .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet vënë theksi tek shpehitë praktike që nxënësi duhet të mësojë dhe përdorimin e mjeteve.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, makinerite dhe materialet e mëposhtme:
- Ekonomi pyjore për të kryer shfrytëzimet pyjore.
  - Makina të automatizuara për shfrytëzimin e pyjeve.
  - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
  - Plane mbashtrimi dhe shfrytëzimi pyjore .
-

### 3. Moduli “Inventarizimi dhe vjelja e gjahut”

Drejtimi: Pyje  
Profili: Shfrytëzim pyjesh  
Niveli: III  
Klasa: 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	INVENTARIZIMI DHE VJELJA E GJAHUT	M-25-658-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në njohjen e karakteristikave të gjahut në vëndin tonë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi kryen vrojtme në sipërfaqet pyjore.</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgimi i terrenit ( rikonjucioni)</li><li>– Zgjedhja e hartës orientuese.</li><li>– Përcaktimi i rradhës së punës.</li><li>– Ndërtimi i grupeve të punës.</li><li>– Përcaktimi i vendodhjes së kafshëve dhe shpendëve .</li><li>– Përgatitja e mjeteve të punës.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të vëzhgojë terrenin .</li><li>– të zgjedhë hartën orientuese</li><li>– të përcaktojë rradhën e punës në rezervat.</li><li>– të ndajë grupet e punës sipas detyrave .</li><li>– të përcaktojë vëndodhjen e kafshëve dhe shpendëve.</li><li>– të përgatisë mjetet e punës .</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vrojtmeve në sipërfaqet pyjore</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi inventarizon shpendët dhe kafshët në zonat pyjore</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përcaktimi i zonës së inventarizimit .</li><li>– Zgjedhja e hartës orientuese për zonën pyjore</li><li>– Zgjedhja e sipërfaqeve provë.</li><li>– Specifikimi i llojeve ( shpendëve dhe kafshëve) nëpërmjet</li></ul>	

- pamjes së jashtme.
- Specifikimi i llojeve nëpërmjet personelit teknik dhe gjahtarëve të zonës.
- Verifikimi i llojeve nga dokumentat e drejtorisë së shërbimit Pyjor. ( Vertetimet që lëshohen për kafshët dhe shpendët).
- Përpilimi i tabelave të inventarizimit për sipërfaqet provë.
- Përlllogaritja me tabela për gjithë zonën.
- Përgatitja e hartës me simbole kafshës dhe shpendësh për zonën e vëzhguar
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë zonën e inventarizimit.
- të zgjedhë hartën orientuese të zonës pyjore.
- të zgjedhë sipërfaqet provë.
- të specifikojë llojet nëpërmjet personave ( teknikë dhe gjuetarë)
- të verifikojë dokumentacionin për llojet.
- të përpilojë tabelat e inventarizimit për sipërfaqe provë.
- të llogarisë për gjithë zonën të gjithë sasinë e gjahut.
- të përgatisë hartën me simbole për kafshët dhe shpendë e zonës.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ato të mbrojtjes së mjedisit gjatë inventarizimit të shpendëve

**RM 3 Nxënësi vjel kafshët dhe shpendët ( gjahun).**

***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i zonës së gjuetisë.
- Zgjedhja e mënyrave të gjuajtjes.
- Vendosja e tabelave lajmëruese për zonën ku do të kryet gjuetia.
- Përgatitja e kurtheve që kapin gjahun.
- Vendosja e kurtheve për gjuajtje.
- Përgatitja e armëve për gjuetinë e shpendëve dhe të kafshëve.
- Përgatitja e municionit për gjueti.
- Evidentimi i kafshëve dhe shpendëve të gjuajtura.
- Evidentimi i kafshëve dhe shpendëve të dëmshme për zonën.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në procesin e gjuetisë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pëcakttojë zonën e gjuetisë së kafshëve dhe të shpendëve.
- të zgjedhë mënyrat më të mira për gjuajtjen e kafshëve dhe shpendëve.
- të vendosë tabelat lajmëruese për zonën se ku do gjuhet për të lajmëruar popullsinë.
- të përgatisë kurthet e kapjes së gjahut duke zgjedhur llojet e tyre.
- të vendosë kurthet në vëndet e përcaktuara gjatë rikonzhucionit të terrenit.
- të përgatisë armën për gjuajtje , duke e zgjedhur tipin dhe cilësinë e saj. ( çifte)
- të përgatisë municionin duke zgjedhur fishekët në varësi të tipit të armës.
- të evidentojë kafshët dhe shpendët e gjuajtura nëpërmjet numërimit të tyre.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gjuajtjes me çifte

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore ose në rezervate gjuetie.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të inventarizimit dhe të vjeljes së gjahut dhe hartimin e tabelave dhe të hartës së gjuetisë me simbolet përkatëse..
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore ndarjen e zonave të inventarizimit ,zgedhen e sipërfaqeve provës specifikimin e lloeve ,verifikimin e gahur, grumbullimin e të dhënave në drejtorite e shtetit për pyor por edhe nga popullsia e zonës dhe nga gjuetarët të përdorë armën e gjahut,
- Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e tabelave të inventarizimit dhe përcaktimin e llojeve dominuese të zonës dhe të ndërtojnë hartën me përfaqësuesit kryesorë të kafshëve dhe shpendëve të zonës.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve..
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e inventarizimit të gjahut , të formave dhe mënyrave të gjuajtjes si dhe të përcaktoje llojet kafshëve dhe shpendët në përgatitjen e hartës me llojet përkatëse të zonës

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor.
  - Mjete pune te ndryshme
  - Komplete veshje e gjuetarit.
  - Pankarta per njoftime te ndryshme .
  - Arma e gjahut dhe fishekë te e llojeve te ndryshme .
  - Kurthe ose leqe si dhe materjale për përgatitjen e tyre
  - Kanceleri per përgatitjen e hartes dhe mbajtjen e shenimeve
  - Tabela te gatshme per te hedhur te dhenat e grumbulluara .
  - Dokumente te D.SH. Pyjor mbi te dhenat e zones. .
  - Harte dhe busull orjentuese në terren.
-